

AKT – THEMELIMI
I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“KASEBATECH” SHPK

Bazuar në vullnetin e ortakëve themelues dhe mbështetur në Ligjin 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, ndryshuar me Ligjin nr. 10475, datë 27.10.2011 vendoset si me poshtë:

Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja dhe Selia e Shoqërisë.

Neni 1:

Themelimi, Themeluesit, Emri.

Sot me date 27.03.2024 themelohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me emrin: “Klastech” Shpk.

Themeluesit e shoqërisë “Kasebatech” janë;

Znj. Vivion Thano, shtetase shqiptare, lindur në Greqi, dhe banues në Tiranë, e datëlindjes 13.04.1993, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, pajisur me ID nr.037196711 dhe nr.personal: J35413064M, e cila redaktoi këtë Akt-Themelimi, në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë nr. 9901 datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar dhe ligjit 9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar.

Neni 2

Objekti i veprimtarise

“Kryerja e veprimtarive ne fushen e teknologjise se informacionit, programimit, programeve kompjuterike dhe sistemeve software. Aktivitet ne fushat e reklamave, marketingut online, konsulence ne fushen e IT, software dhe hardware solutions, krijimi dhe menaxhimi i faqeve kompjuterike, sherbime web design, programime kompjuterike dhe elektronike.”

Neni 3

Kohëzgjatja e shoqërisë

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një periudhë të pacaktuar.



Neni 4

Selia e shoqërisë

Shoqëria e ka selinë e saj në adresën: Selia e shoqërisë shoqërisë është në adresën: Rruga "5 Maji", Rezidenca Concord Center, kati dyte, Tirane, Shqipëri".

Kreu II

Kapitali i shoqërisë

Neni 5

Vlera dhe pagesa e kapitalit të paguar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 500.000 (pesëqind mijë) lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tyre si vijon :

Lloji i kontributit është në para në vlerën 500.000 (pesëqind mijë) lekë, i ndarë në 1 (një) kuotë si më poshtë;

- **Z. Vivion Thano**, është zotërues i 1 (një) Kuote, që i korrespondon 100 % (njëqind për qind) të Kapitalit të Shoqërisë.
- Kapitali themeltar i shoqërisë është shlyer dhe nënshkruar teresisht nga ortaku i shoqërisë.

Kreu III

Administratori i shoqërisë.

Neni 6

Emerimi dhe kohezgjatja e Administratorit.

Asambleja e përgjithshme zgjedh një ose më shumë persona fizike si administratorë të shoqërisë për një periudhë pesë vjeçare (5 vjet), në pajtim me parashikimet e Ligjit 9901 datë 14.04.2008, i ndryshuar. Emërtimet do të jenë individuale dhe sipas një vendimi të marrë me shumicë të zakonshme nga Asambleja e Përgjithshme.

Administrator i kësaj shoqërie caktohet Znj. Vivion Thano, shtetase shqiptare, e datëlindjes 13.04.1993, pajisur me Letërnjoftim nr.personal: J35413064M me zotësi të plotë juridike për të vepruar.



Kreu IV
Dispozitat Përfundimtare.

Neni 7

Marrëdhëniet e punësimit në shoqëri do të rregullohen nëpërmjet kontratës së punësimit që lidhet midis palëve në mbështetje të Kodit të Punës si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ushtrimit të veprimtarisë private, midis ortakëve, punonjësve dhe personave të tretë, kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim, mbetet në kompetencë të Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Shoqëria do të ketë vulën e saj ku janë përcaktuar dhe inicialet e emërimit tregtar.

Modalitet për ndryshimin dhe kompetencat e administratorit, kompetencat dhe marrja e vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme, zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit themeltar, etj, do të rregullohen nga Statuti i Shoqërisë dhe Ligji 9901 14.04.2008 "2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar si dhe Ligji 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar.

Ky akt themelimi është përpiluar në tre kopje me vlerë të njëjta me origjinalin.

Tiranë, më datë 27.03.2024.

ORTAKU THEMELUES

VIVION THANO

